

SYLLABUS I LËNDËS: Etikë biznesi

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ekonomisë
Titulli i lëndës:	Etikë biznesi
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II, Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Përcaktohet nga Dekanati
Mësimdhënësi:	Prof. asst. Liridon Veliu
Detajet kontaktuese:	liridon.veliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda ofron njohuritë e përgjithshme dhe bazë të së drejtës, rregullimin dhe definimin e etikes në biznes. Studentëve kjo lëndë ju ofron mundësi të zhvillojnë njohuri mbi rolin dhe mënyrën e funksionimit të etikes tij. Konsiderata do t'i jepet aktiviteteve praktike të etikes në përgjithësi. Një analizë më detaje do t'i kushtohet edhe kodeve, ligjeve, akteve, rregulloreve ekonomike- juridike mbi të cilat funksionon etika. Lënda "Etikë biznesi" është planifikuar të ndihmojë studentet që të përmirësojnë kontekstin e tyre personal brenda fushës së administrimit të biznesit, në Kosovë dhe me gjerë. Sjelljeve etike në biznes, në komunikim, në qarkullim ekonomiko- biznesor e juridik, si dhe mundësitë për aplikimin e tyre ndaj aktorëve dhe faktorëve të tjerë relevant ekonomik. Rëndësi do ti kushtohet edhe problemeve socio ekonomike e juridike.</p>
Qëllimet e lëndës	<p>Qëllimet e kësaj lëndë mësimore, janë: njohja e studenteve me përmbajtjet, normat, vlerat, standardet themelore etike, si dhe kodekset e sjelljeve etike gjatë aktiviteteve ekonomike dhe biznesore të subjekteve të ndryshme, pjesëmarrjes në operacionet, aktivitetet, transaksionet dhe përgjegjësitë.</p> <p>Ky modul do t'i pajisë studentët me njohuri lidhur me frymën dhe logjikën e etikës së biznesit. Ata do të jenë në gjendje që të kuptojnë dhe interpretojnë zhvillimin e biznesit në pajtim me rregullat morale, etike dhe ligjore duke i edukuar ata me frymë pozitive të zhvillimit të biznesit dhe implikimet të cilat i sjellë biznesi jo i ligjshëm për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre, shoqërinë dhe biznesin në përgjithësi e cila duhet të shkojë paralel me normat bazë dhe rregullat e moralit dhe të etikës gjatë kryerjes së bizneseve.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies	<ul style="list-style-type: none">✓ Të kuptojë parimet themelore të etikës në biznes,✓ Të qartësojë pozitën dhe rolin e kësaj lënde tani dhe në të ardhmen në vendin tonë, mbi interesat e kësaj lëmie,✓ Të kritikojë dhe debatojë çështjet aktuale të lëndës dhe të

	<p>argumentojë qëndrimin e vet duke u bazuar në parimet dhe rregullat etike,</p> <p>✓ Të rrisë aftësitë e studentit për të kuptuar peshën e etikes në biznes,</p> <p>✓ Të rrisë aftësitë e studentit për të kuptuar shprehitë e mirëfillta administrimit në biznes,</p> <p>✓ Të rrisë aftësitë e studentit në aspektin personal dhe profesional– zbatues të lëndës në trendin evropian dhe atë global,</p> <p>✓ Pasojat e jo transparencës,</p> <p>✓ Pasojat e korrupsionit</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	/	/	/
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	20 min.	15	5
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokviume	2	2	4
Koha e studimit vetanë të studentit	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projekte, prezantime	1	4	4
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjërates, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike.</p> <p>Metoda e punës gjatë orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupore, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët.</p> <p>Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimin për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të lëndës.</p>		
Metodat e vlerësimit	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:</p> <p>a) vijueshmërisë në ligjërata: 5 pikë</p> <p>b) aktivitetit dhe punimi seminarik: 15 pikë</p> <p>c) testi i parë: 40 pikë</p> <p>d) testi i dytë: 40 pikë</p> <p>Gjithsej: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë theksuara.</p>		
Literatura			

Literatura bazë:	- Doloreza SINANAJ, “Etika e Biznesit”, ISBN: 978-9928-197-15-3, Tiranë, 2016 - Hysen ÇELA, “Etika e Biznesit”, Tiranë, 2009
Literatura shtesë:	- Denis Collins, Patricia Kanashiro, “Business Ethics: Best Practices for Designing and Managing Ethical Organizations”, Third Edition, SAGE Publications, 2021 - Laura Hartman, Joseph DesJardins, Chris MacDonald, “Business Ethics: Decision Making for Personal Integrity & Social Responsibility”, McGraw-Hill Education, 2020 - William H. Shaw, “Business Ethics: A Textbook with Cases”, 9th Edition, ISBN-13: 978-1305582088, 2015
Punime shkencore:	- Santos, F. M., & Eisenhardt, K. M. (2022). Constructing markets and shaping boundaries: Entrepreneurial action, in markets as politics. <i>Academy of Management Journal</i> , 65(1), 1–21. https://doi.org/10.5465/amj.2019.0781 - Crane, A., Palazzo, G., Spence, L. J., & Matten, D. (2021). Contesting the value of “creating shared value”: Revisiting business ethics. <i>Journal of Business Ethics</i> , 169(2), 237–251. https://doi.org/10.1007/s10551-019-04225-0 - Kaptein, M. (2020). The moral entrepreneur: A new component of ethical leadership. <i>Journal of Business Ethics</i> , 167(3), 365–379. https://doi.org/10.1007/s10551-019-04144-0 - Kolk, A., Rivera-Santos, M., & Rufin, C. (2020). Reviewing a decade of research on the “base/bottom of the pyramid” (BoP) concept. <i>Business & Society</i> , 59(1), 31–66. https://doi.org/10.1177/0007650316677304
Plani i dizajnuar i mësimi	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e I-rë:</i>	Prezantimi i syllabusit / Etika një faktor më shumë për vendimmarrje etike
<i>Java e II-të:</i>	Parimet kryesore etikë në biznes
<i>Java e III-të:</i>	Arsyetimi moral, etika dhe përcaktimi për vlerat etike
<i>Java e IV-të:</i>	Konfliktet në biznes
<i>Java e V-të:</i>	Pjesëmarrësit në funksionimin e biznesit dhe të çështjeve etike
<i>Java e VI-të:</i>	Respekti, përgjegjësia dhe rezultatet
<i>Java e VII-të:</i>	Testi i parë
<i>Java e VIII-të:</i>	Diskriminimi në punë dhe qasja etike
<i>Java e IX-të:</i>	Kultura dhe vlerat e korporatës / Rolet dhe Përgjegjësitë morale të korporatave
<i>Java e X-të:</i>	Programet e menaxhimit etik
<i>Java e XI-të:</i>	Transparenca e biznesit
<i>Java e XII-të:</i>	Korrupsioni dhe origjina e tij
<i>Java e XIII-të:</i>	Raportimi dhe auditimi etik
<i>Java e XIV-të:</i>	Dilemat etike dhe zgjidhja e tyre
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dytë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit.

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata.

Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.